



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.060/01-23027/24
Kaçanik, 24.09.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VIII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24.09.2024, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00. Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani,. Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari-Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Zahir Doda-DA, Ramadush Osmani-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Pranvera Loku- Zharku-DZHET.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoruan: Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Mavije Murseli, Asistente e Kryesues i Kuvendit

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të KPF-së për vitin 2024, data 24 shtator. Para se të fillojmë me rendin e ditës, drejtori Bahri ka një kërkesë. Ai ka sjellë një dokument sot dhe do të doja të dija nëse ke diçka për të thënë rreth kësaj. Pse kërrove ta futësh në rendin e ditës? Por duhet të marrë miratimin e të gjithëve.

z. Bahri Selimi: Mundësisht, do të doja të futet në rendin e ditës një shumë e vogël prej 4,600.00€ për sallën edukates fizike në SHFMU "Isuf Gervalla" në Biçec. Në mungesë të mjeteve, ligji na lejon 100% rialokimin mes drejtorisë dhe projekteve. Ne jemi duke e shfrytëzuar këtë opsion, pasi deri në 5% nuk shkon në ministri, kjo shkon në KPF dhe Kuvend dhe mund të ekzekutohet pa kërkuar aprovimin e ministrisë. Kjo është e rëndësishme, sepse na vie mirëkuptimi për t'u përballur me obligimin ndaj operatorit ekonomik, nëse nuk e realizojmë tani, do të na mbetet obligim për vitin e ardhshëm.

z. Rustem Zenuni: Ne jemi pro që të futet në rendin e ditës.

z. Agim Mani: Po, megjithatë na ka ardhur tani, por nuk e kemi lexuar mirë.

Kryesuesi i Kuvendit: Domethënë jeni të pajtimit që me u futë si pikë e rendit ditës dhe me u përcjell në Kuvend. Atëherë fillojmë me mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të KPF-së, në të cilën është parapa me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027;

3. Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe vendimit 01Nr.60/01-14084/24 për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e këtij komiteti;
4. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr.320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj - Gabrricë;
5. Plani i Veprimit në Mjedis, me veprim klimatik;
6. Draft-Plani Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028;
7. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2024;
8. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku;
9. Propozim Vendim Për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore deri në 5% sipas Buxhetit të vitit 2024.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Vetëm dëshiroj të diskutoj rreth pikave të rendit të ditës që na kanë ardhur. Edhe Kuvendi ka tri pika shtesë, ndoshta nuk ka pasur nevojë të trajtohen nga KPF, por ka nevojë për sqarim për këtë pikë, e cila është plotësim ndryshimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse është trajtuar në Kuvend, plotësim ndryshimi shkon vetëm në Kuvend. Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 26.07.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-16842/24

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini, sipas procedurave ligjore, projekti i buxhetit ka ardhur te Kuvendi më 1 Shtator, dhe menjëherë kemi realizuar një debat publik si Komitet për Politika dhe Financa. Në këtë debat publik ka marrë pjesë vetëm Rustemi si anëtar i komitetit, së bashku me administratorët e fshatrave, drejtorët e shkollave dhe përfaqësues të tjerë që preken nga buxheti i komunës. Ndërsa nuk ishte në masën e kënaqshme siç do të dëshironim, debati

publik u mbajt siç ishte planifikuar. Sigurisht, edhe ekzekutivi ka mbajtur dëgjime buxhetore gjatë periudhave qershor, korrik dhe gusht. Tani është koha që projekti i buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitin 2026-2027, të vijë në KPF dhe Kuvend për miratim. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin

z. Bahri Selimi: Është propozuar buxheti pas konsultimeve publike. Këtu janë të paraqitur buxheti për vitin 2025 dhe vlerësimet për 2026 dhe 2027. Për vitin 2025, buxheti është 12,592,239.00 €. Ne kemi bërë renditjen sipas kategorive ekonomike dhe shpërndarjen sipas qarkores buxhetore 2025/02, e datës 14 gusht.

Si zakonisht, shpenzimet për paga po zënë një shumë të konsiderueshme të buxhetit. Mallrat dhe shërbimet janë me një pikë. Ndër shpenzime, Paga dhe Mëditje 6.865.266.00 €, Mallrat dhe Shërbimet 1.514,233.00 €, Shpenzimet e Shërbimeve Komunale 225,000,00 €, Subvencionet dhe Transferet 514,157.00 €, Shpenzimet në Investimet kapitale 3,473,583.00 €. Për dallim nga viti aktual, ne kemi rritur shumën me 510,000.00€, megjithatë rritja e buxhetit është shumë simbolike, vetëm 5.3%.

znj. Ardita Rrahmani: Ne e kemi parë pikën për draft buxhetin dhe më vjen keq që nuk kam mundur të marrë pjesë për arsye personale, sepse ndryshe nuk do ta kisha lënë pa ardhur. Jo për tjetër, por për t'ju mbajtur të informuar me kërkesat që vijnë në debate, çfarë parashikoni dhe çfarë ndryshimesh bëni kur i sjellni në Kuvend. Kjo ka qenë kritike në vitet e kaluara, dhe e kam përmendur edhe vitin e kaluar: pse të vijë në debat, nëse unë kërkesat i paraqes gjatë vitit në Kuvend dhe nuk merren parasysh?

Kam qenë detyruar, nga obligimet e mia si pjesë e komitetit, të vij në debat publik, ku gjithashtu i kam paraqitur kërkesat e mia, por përsëri ato nuk janë përfshirë në buxhet. Megjithatë, kjo nuk ishte arsyeja e mungesës sime atë ditë, por arsye krejt personale.

Ajo që më vjen mirë është që ka rritje, por më vjen keq që rritja e buxhetit është kaq e vogël. Më shqetëson fakti që shumica e buxhetit po shkon për paga. Mirë që ka ku të shkojë, por ato po shkojnë në paga. Drejtori tha se vetëm po e paraprin atë që doja të thoja: nëse keni rritje pagash, vetëm po flitet, ndërsa barra do të mbetet te komuna, dhe vetëm shërbyesit civil do të përfitojnë.

Dyshoj që më pas do të ketë një rritje të buxhetit me rritjen e pagave; shpresoj të jetë e kundërta, por duke pasur parasysh vazhdimin e situatës deri tani, dyshoj që buxheti do të rritet për të mbuluar realizimin e projekteve kapitale.

I kam parë projektet që i keni parapa dhe janë disa kode të reja. E kuptoj qartë se çfarë janë këto kode dhe pse duhen, por vazhdoj të mos kuptoj pse ato nuk përfundojnë dhe përsëriten vit pas viti, duke menduar për 5-6 vitet e fundit. Një kod që nuk mund të tërheqë ndonjë investim. Jam dorëzuar përballë nivelit qendror, por pse jo përballë organizatave ndërkombëtare? Pse të mos dalim jashtë Kaçanikut për të kontaktuar ndonjë investitor dhe për të realizuar diçka, madje si për bamirësi? Më vjen keq që jemi në këtë situatë, duke pritur që dikush të na mbushë ndonjë kod për t'u përmbushur.

Kemi me shtjerrë debatin në Kuvend, edhe pse për ne që jemi në KPF, është shumë e ripërsëritur. Shpresoj që në fjalët e mia të mos kapet askush tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket buxhetit, a do të ketë ndryshime? Sigurisht që mund të ketë, sidomos tani që jemi në kohë fushate, dhe premtimet janë më të mëdha. Por nuk janë vetëm premtime; ato janë edhe nevoja reale. Mendoj se çdo parti, qoftë aktuale apo ndonjë tjetër që do të vijë pas saj, duhet të ndërmarrë hapa për të ndryshuar këtë buxhet, sidomos në aspektin e pagave. Pagat në sektorin publik janë tmerrësisht të ulëta në krahasim me sektorin privat. Kur e shoh sektorin publik, situata është alarmante: rreth 70% e punonjësve kanë paga nën 500.00 €, që është tmerrësisht e ulët për nevojat e krijuara sot, siç është shporta e qytetarit.

Unë besoj se para miratimit të buxhetit në nivel vendi, ky buxhet do të pësojë ndryshime. Kjo nuk mund të ndikojë nga ne, sepse ne duhet të bëjmë planifikime bazuar në atë çfarë është. Nëse ata mendojnë të rrisin koeficientin ose ndonjë gjë tjetër, detyrimisht do të ndryshojë edhe

ky projekt buxhet, por nuk e ndryshon projeksionin tonë, pasi ngritja bëhet vetëm për grantet specifike që lidhen me pagat dhe mëditjet.

Do të ishte mirë që buxheti të rritej në investime kapitale dhe subvencione, por kjo mbetet në mëshirën e nivelit qendror, kushdo që do të jetë ai. Kjo është një kategori që bazohet në të hyra vetanake dhe një formulë që ndan grantin e përgjithshëm aktual. Nëse do të ketë ndryshime, besoj se do të jetë e mirëseardhur, qoftë për ne, qoftë për qytetarët. Por sidoqoftë, kjo është pasqyra aktuale dhe ne duhet të bazojmë planifikimet tona në këtë pasqyrë.

z. Rustem Zenuni: Sponsoruesi i ndryshimit të ligjit për pagat, për shembull, e ka paraparë koston financiare, pasi çdo ligj ka koston e vet financiare. Kjo do të thotë se në aspektin e investimeve kapitale dhe shërbimeve nuk mund të na kufizojnë ato që janë të parashikuara. Unë do të kisha dëshirë që rritja e buxhetit të ishte më e madhe, por ky është trendi i zhvillimit ekonomik këtu tek ne, dhe duhet të pajtohem me këtë ngritje.

znj. Ardita Rrahmani: Kam një pyetje që ka të bëjë me kontratat kolektive. Çfarë do të ndodhë në realizimin e obligimeve që rrjedhin prej këtyre kontratave? Nga do të merren mjetet për to? Cilat kategori do të preken në këtë rast? A keni një projeksion se si do të filloni me zbatimin e tyre dhe nga do t'i merrni paratë?

Kryetari i Komunës: Nuk e dimë se kur vjen vendimi përfundimtar, për shkak se në shkallën e parë, bashkë me drejtorin e Arsimit, kemi kontestuar për shkak të parregullsive që po i vërejmë. Nuk dua të hyj në detaje mbi këto parregullsi, por e ndiej veten si obligim moral t'i kundërshtoj aty ku ka parregullsi. Për të tjerat, i pranojmë në heshtje dhe duhet t'i ekzekutojmë derisa të vijë vendimi i apelit.

Kemi mbetur në këtë situatë duke pritur, dhe shpresojmë që shumat të jenë më të vogla, që do t'na japë mundësinë të gjejmë hapësirë. Sepse na jepet mundësia prej thesarit me na pyet se ku tërhiqen këto mjete. Mirëpo, nëse vjen siç ka filluar në komunat e tjera, atëherë do të na mbeten të gjitha investimet kapitale. Viti i ardhshëm parashihet të jetë një vit i vështirë, ne kemi menduar që një pjesë e mjeteve do të vijë këtë vit dhe një pjesë vitin e ardhshëm, por siç po duket, do të vijnë në fillim të vitit të ardhshëm.

Sipas gjitha gjasave, do të jetë një vit i vështirë, siç po ndodh me shumë komuna të tjera, që do të bllokohen me llogari, duke u bllokuar ashtu siç u ka ndodhur komunave të tjera. Do të kem edhe një opinion të modifikuar, por jemi të pafuqishëm, pavarësisht se kemi ngritur këtë çështje si kryetarë të komunave përmes asociacionit. E dimë që është një vendim i ish-qeverive që u ka bërë barrë kryetarëve të komunave padrejtësisht, por nuk kemi pasur asnjëherë mundësi për ta ndryshuar këtë deri më tani.

Kohet e fundit flitet diçka mirë, por nuk ka asgjë konkrete. Nëse arrijmë ta implementojmë këtë kontratë vitin e ardhshëm, nuk e di si do të shkojë dhe nuk mund të paragjykoj se çfarë veprimesh duhet të marrim. Por seriozisht, do të jemi në kolaps, sepse përmbaruesit nuk pyesin.

znj. Ardita Rrahmani: Po pyes nëse është thashethem publik që po flitet se gjatë vitit të ardhshëm do të ketë nevojë për ekzekutimin e disa projekteve, dhe nëse do të ekzekutohen, do të bien nga ky buxhet. Çfarë do të ndodhë me këto projekte? A keni informacione se sa është shuma për investimet kapitale dhe a mund të më thoni më shumë rreth kësaj?

z. Bahri Selimi: Shuma për investime kapitale është 1.5 milion, por këtë vit shumicës së komunave u janë tërhequr mjetet nga thesari. Ato kanë proceduar më shpejt lëndët gjyqësore, po i nget që nuk i kanë kontrolluar shumë, ndërsa tek ne ka pasur vonesa në shqyrtimin e disa rasteve, p.sh. disave nuk i ka takuar pushimi i lehonise dhe kjo është analizuar mirë nga drejtoria e Arsimit. Ka raste ku disave nuk ju ka takuar shujta ndoshta ka qenë arsimtarë që ka pasur pushimin vjetor për vitin 2020, dhe ky proces gjithashtu ka ngadalësuar situatën për ne. Tek komunat që kanë tërhequr mjetet, kanë filluar të paguajnë për pagat dhe mëditjet. Edhe ne, sa herë që na tërheqin në paga dhe mëditje, nuk kemi ndonjë rrezik. Zakonisht, komunat ose

nuk i kanë vendet e përcaktuara 100% për pagat, ose lënë hapësirë për mëditje simbolike. Por kur fillojnë investimet, atëherë paraqitet rreziku, do të thotë që premtimet që kemi dhënë këtë vit për vitin e ardhshëm mund të rrezikohen diku diku.

znj. Ardita Rrahmani: Drejtor, jo dikun, po përgjysmë. Më shumë se gjysma, ose 3.4 milion, janë për investime kapitale.

z. Bahri Selimi: Gjykata shkon parcialisht vendimet dhe lëndë ti ekzekutu, ishalla kemi fat që mundet me qenë shpërndarja për s'paku dy vite dhe obligimi është më i përballushmë.

znj. Ardita Rrahmani: A ka ndonjë komunikim në këtë rast mes personave zyrtarë që përfaqësojnë, sepse kjo shkon përmes sindikatës? Sa e kanë mirëkuptimin ndaj kësaj? A pyeten ata nëse këto pagesa do të realizohen në një mënyrë parciale apo jo?

z. Bahri Selimi: Marreveshja i ka pengesat e veta nëse nuk e kemi pasur të planifikuar për këtë vit.

Kryesuesi i Kuvendit: Është e vështirë të arrihet një marrëveshje kolektive me katërqind persona, sepse prej katërqind individëve, një mund të dalë dhe ta prishë atë marrëveshje. Ndërsa marrëveshja kolektive si koncept është e rëndësishme, marrëveshja individuale përballet me disa probleme të tjera.

znj. Ardita Rrahmani: E si ndikon kjo në performancë?

z. Bahri Selimi: Mund të ndodhë një klasifikim i gabuar i shpenzimeve nëse i merr te investimet kapitale, dhe auditori mund ta klasifikojë si një keqklasifikim të shpenzimit. Nëse ai e modifikon raportin, dhe ti ke një raport të modifikuar, atëherë nuk do të fitosh grant për performancën.

znj. Ardita Rrahmani: Kam fjalën për komunat e tjera: në realizimin e buxhetit për investimet kapitale, kanë arritur 100% të realizimit. Çfarë ka ndikuar në performancën e tyre? A kanë dalë më mirë apo më keq?

Kryetari i Komunës: Janë eliminuar sepse një nga tri kushtet nuk plotësohet, domethënë raporti i auditorit që del i modifikuar e eliminon menjëherë nga gara.

z. Bahri Selimi: Me fol të drejtën, një pjesë e mjeteve i kemi transferuar pak më herët përmes Kuvendit, që të sigurojmë se nuk do të kemi keqklasifikim.

z. Agim Mani: Meqenëse u diskutua çështja e pagave, unë mendoj dhe shpresoj do Zoti e të rriten pagat. Sa i përket propozimit që ka bërë ekzekutivi, shpresoj të realizohet ashtu siç është planifikuar. Megjithatë, kam shqetësimin tim në lidhje me praktikën e mëparshme: ndryshe votohet, ndryshe realizohet.

Kam një kërkesë për drejtorin: forma e tabelave që po paraqiten nuk është e përshtatshme. Me të vërtetë, është e pakuptimtë dhe nuk e lejon një vlerësim të qartë. Do të ishte më mirë që ato të paraqiten në një formë më të lexueshme dhe të kuptueshme për ne.

Këtë propozim për buxhet e keni bazuar në një plan strategjik dhe keni marrë parasysh vlerësimet për vitet 2026 dhe 2027. Megjithatë, sa i përket të hyrave vetanake, nëse ka mundësi, drejtor, do të ishte mirë të paraqisnit edhe vitin 2024. Cila është arsyeja që keni bërë planifikimet në këtë mënyrë?

z. Bahri Selimi: Agim Sa i përket tabelave, tabela 4.1 tregon se cilat drejtorive do t'i alokohen mjetet. Ndoshta, kjo është një ngarkesë për ju për tri vitet e ardhshme. Tabela është në formë standarde, por kur skanohet, po del pak e paqartë. Megjithatë, për Kuvendin, mund të ju dërgoj edhe të sistemit.

z. Agim Mani: Drejtor, lutem dërgojeni prej sistemit, sepse është një mundësi dhe me të vërtetë nuk po vërehet qartë.

z. Bahri Selimi: Së pari, buxhetin nuk e kemi caktuar ne, por na e ka caktuar qeveria, mbi 12 milion. Ne e kemi bërë shpërndarjen. Pse po thua se vitin e ardhshëm do të realizohet ndryshe?

z. Agim Mani: Ndryshe po planifikohet dhe ndryshe po realizohet, duke pasur parasysh rialokimin, bartjen dhe transferin e mjeteve. Vetëm këtë vit, sa transfere të mjeteve keni bërë në krahasim me planifikimin?

z. Bahri Selimi: 2024 është plani Agim, jo realizimi do të thotë plani i këtij vitit.

z. Agim Mani: Për këta jam i interesuar, këta e ke marr vetëm të të hyrat vetanake nuk e ke marr 2024, të planifikimet tjera.

z. Bahri Selimi: Buxheti 2024 aktual po shkrun d.m.th duhet me u nis prej këtij vitit me pa sa është rrit, gjithmonë bëhet krahasimi sa janë rrit edhe të të hyrat. Këtë vit i kemi 924,200.00€ planifikime të të hyrat vetanake ndërsa 951,401.00€ kanë me qenë vitin 2025. Kjo është veç për baz krahasimi dhe gjithmonë paraqitet kjo pra nuk është realizimi por planifikimi i këtij vitit tana fillon planifikimi i vitit 2025, 2026.

z. Agim Mani: Drejtor ti e ke cek plani afatmesëm i të hyrave totale i buxhetit komunal për vitin 2025-2027, mirëpo këtu e ke paraqit edhe vitin 2024.

z. Bahri Selimi: Ne jemi proces planifikimit buxhetit 2025 dhe vlerësimet 2026-2027, po këtu paraqitet si kolon për me i pa cili lloj hyrave ka me u rrit, ka me pas ndryshim ose ka me pas ulje, kjo është informatë shtesë. Nëse dëshironi edhe qarkoren e forvardoj shkruan se duhet me u bashkëngjijt propozim buxhetit tabela 4.1 që the nuk po shihet mirë, 4.2 investimet kapitale dhe 4.3 me këtë përmbajtje është pjesë e obligueshme me dorëzua bashkë me propozim buxhetin.

z. Agim Mani: E kam një pyetje drejtor vitin e kaluar është miratua buxheti pa ngritje pagës d.m.th miratimin e buxhetit kur e kemi bërë vitin e kaluar e kemi bërë planifikimin me 105 koeficienti ndërsa në vitin 2024 ka qenë 110, ku i keni marr këto mjete?

z. Bahri Selimi: Me ligjin e buxhetit vjetor me u rrit nga 5 euro vlera e koeficientit, najë kanë dërgua në qarkoren dytë me koeficient 110. Në këtë vit nuk kanë thënë 115, ka me u bërë por nëse rriten pagat mbasi të votohet ky buxhet për buxhetin e njëjtë e kam fjalën nëse rriten pagat krejt organizatat kanë me u detyrua me marr mjete në kategori tjera për me i kompensuar pagat.

znj. Kadrije Lika-Troni: Plani afatmesëm i të hyrave në tabelën 4.3 për tatimin mbi pronën tregon se buxheti aktual është 391,545.00€, ndërsa plani për vitin 2025 është 350,446.00€. A mundet plani të jetë më i ulët se kjo? Kur e shohim këtë vit, kemi një vlerë prej 40,000.00€ më shumë. A nuk është e arsyeshme që plani për vitin e ardhshëm të jetë më i lartë?

z. Bahri Selimi: Kjo ka ardhur në bazë të Departamentit të Tatimit mbi Pronën. Shumë shtëpi banimi po vijnë me vlerë zero. Nuk mund të themi se është bërë keq deri në 15,000.00€, që është zbritja e tatimit për banimin primar. Për këtë vit, zbritja e tatimit mbi pronën do të jetë 30,000.00€.

z. Rrustem Zenuni: Drejtor, një pjesë tjetër e tatimeve janë ngarkuar, domethënë bizneseve u është rritur vlera. Personalisht, mua më është rritur vlera e shtëpisë, dhe kam paguar tatim më shumë.

Kryetari i Komunës : Në komunat e vogla, ndoshta 10 personave u është rritur vlera, por për 50 të tjerë vlera ka rënë në zero, sepse objekti është me vlerë të ulët.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nisem nga ajo që është e padrejtë, ai që ka më shumë paguan më shumë, por edhe ai që ka më pak paguan më pak, dhe jo të mos paguajë fare. Kjo nuk është një çështje që varet nga ne, por drejtori e sqaroi planifikimin dhe arsyetimin pse është planifikuar kështu.

Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027. KPF këtë pikë ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe vendimit 01Nr.60/01-14084/24 për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e këtij komiteti;

Kryesuesi i Kuvendit: Është zavendësimi i Rabijes me Edona Luzhen , a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

Aprovoj

Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe vendimit 01Nr.60/01-14084/24 për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e këtij komiteti.

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr.320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj - Gabrricë;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kam një pyetje për drejtorin Suhad, kemi pasur raste të ngjashme edhe më herët, mirëpo nuk e di nëse këto shpenzime kanë mundur të mbulohen apo jo. A janë mbuluar ato shpenzime?

z. Suhad Dullovi: Edhe pse Agjencia e Dëmeve i ka miratuar, qeveria ende nuk i ka ekzekutuar pagesat.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr. 320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj - Gabrricë;

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Plani i Veprimt në Mjedis, me veprim klimatik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: E kam parë draftin e planit dhe e kam analizuar çfarë kam mundur të vërej. Kam vënë re disa gjëra, por kjo le të mbetet për t'u diskutuar dhe do të ketë informata edhe më të mira në Kuvend. Po e marr një shembull: në hartimin e planit, përmendet ndarja se në cilat vende në komunën e Kaçanikut janë furnizuar me bifurkacion. U përmendën tri kategori të cilat menaxhohen vetë dhe që shërbehen me bifurkacion, si dhe ato që nuk kanë shërbim fare, pa bifurkacion.

Përveç malit, u përmend fshati Kovaçec, i cili është kategorizuar me ato fshatra që shërbehen me bifurkacion. Mirëpo, në realitet, në seancën e kaluar kam pyetur disa banorë atje dhe ata treguan se jo i gjithë fshati shërbehet me bifurkacion, por vetëm menaxhohet. Prandaj, do të ishte më mirë që dokumenti të përputhej me realitetin e komunës së Kaçanikut.

Mund të jenë ndonjëherë te nevojshme disa ndryshime, drejtor, por mbasi është një dokument i rëndësishëm, do të ishte mirë të intervenohej ose të korrektohej ky gabim.

z. Qamil Stagova: Është pjesërisht e furnizuar me bifurkacion, ndërsa pjesa tjetër menaxhohet vetë.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse nuk gaboj, thanë se 70% e fshatit vetë menaxhohet. Prapë po them, nuk kam fakte të konfirmuara, por në bazë të komunikimit me banorët e atij lokaliteti, duket se 70% menaxhohet vetë, ndërsa në draft përmendet se janë në kategorinë që shërbehen me bifurkacion. Ndoshta është një detaj i vogël, por përderisa është një dokument, do të ishte mirë të intervenohej dhe të pasqyrohej saktësisht gjendja faktike. Përndryshe, ka shumë rregulla të mira se në atë që është paraqitur.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

Aprovoj

Plani i Veprimit në Mjedis, me veprim klimatik

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Draft-Plani Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika –Troni: Desha të nderlidhem te lokalitetet dhe kam një pyetje për drejtorin e Arsimit: A është i përshtatshëm orari për nxënësit? Sepse këtë vit nuk kam vënë re ndonjë ndryshim. Për shembull, nxënësit e Biçecit nisen në orën 12:25, domethënë një orë më herët, dhe vijnë në shkollë duke shëtitur rrugëve. Këtu flas për nxënësit e klasës dhjetë, që janë fillestarë dhe mund të devijojnë shumë për shkak të orarit të papërshtatshëm. Gjithashtu, në Kovaçec, të paktën nxënësit nuk kanë transport. Edhe pse kanë transport shumë afër rrugës, ata që janë më larg nuk e kanë këtë mundësi. Nuk kam vënë re ndonjë ndryshim që është bërë për këtë vit në këtë drejtim.

z. Ramadush Osmani: Janë rendet e udhëtimit që miratohen për një vit, dhe zakonisht kompanitë ofertuese ofrojnë rendin e udhëtimit për relacionet e caktuara. Nëse vërehet se një rend i udhëtimit nuk i përshtatet një kategorie të udhëtarëve, atëherë ata mund të kërkojnë ndryshimin e këtij rendi me kërkesë të udhëtarëve apo me sugjerim të kompanisë. Zakonisht, kompanitë e përshtatin rendin e udhëtimit në bazë të lokacionit, veçanërisht për nxënës, duke marrë parasysh orarin e shkollave të mesme, të cilat fillojnë në orën 08:30. Në këtë kontekst, zakonisht e përshtatin ardhjen në Kaçanik për në orën 08:00. Kur nxënësit lëshojnë shkollën, kompanitë e kanë planifikuar orarin për t'i marrë ata, pasi ndoshta edhe ato e shqyrtojnë

aspektin e leverdishëm, duke u munduar të realizojnë dy rende të udhëtimit brenda një ore. Kjo gjithashtu përfshin një kosto financiare, por është e lejueshme sipas rregulloreve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

Aprovoj

Draft-Plani Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Megjithëse herave të tjera që e keni sjellë këtë raport në Kuvend, unë ju kam kritikuar se në këtë formë nuk është mirë të paraqitet ky raport. Ju e dini se në KKSB, përbërja e saj nuk është gjithëpërfshirëse dhe fatkeqësisht ka mungesë udhëzimesh. Kuvendi nuk është pjesëmarrës në këtë proces, dhe e vetmja mënyrë që kemi është kjo, e cila është e mangët. Me këtë raport, qytetarët nuk janë të informuar, as ne si asamblistë në Kuvend nuk jemi të informuar, sepse raporti është i pamjaftueshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket kësaj, është një udhëzim administrativ që përcakton qartë se kush duhet të jetë anëtar i KKSB-së. Kuvendi nuk përmendet aty përveç organeve komunale, specifikohet se kush tjetër duhet të përfshihet, si bashkësitë fetare, stacioni policor, dhe FSK-ja. Pra, përbërja e atij këshilli është sipas udhëzimit administrativ të miratuar. A është ai udhëzim i mirë apo jo, ne mund ta diskutojmë, por megjithatë specifikohet shumë qartë se kush duhet ta përbëjë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Kjo është forma që na është raportuar si Kuvend për raportet e tyre dhe për zhvillimet që ka bërë KKSB.

Meqë nuk ka kush diçka tjetër, a jeni të pajtimit që Raporti i KKSB t'i adresohet Kuvendit të Komunës. Për me ia kaluar Kuvendit të Komunës Raportin e punës së KKSB votuan njëzëri të gjithë anëtarët e KPF. Në saje të kësaj del konstatimi së; KPF vendosi që,

Raporti i Punës së KKSB –së për 6 mujorin e parë 2024, i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë në formë informate.

8. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Shqetësuese është numri në rënie i nxënësve që po vijojnë shkollën. Unë as nuk e vë në dyshim që ata vazhdojnë, por për fat të keq, nuk po e zgjedhin drejtimin që është në komunën e Kaçanikut. E di që disa nxënës orientohen edhe në drejtime që nuk janë në Kaçanik, por në Ferizaj. Mandej, zhvendosja dhe bartja e popullsisë është një faktor tjetër, por shqetësim në vetvete mbetet numri i rënies të nxënësve në shkollat tona.

z. Agim Mani: Në statistikën e fundit, më duket se numri i nxënësve është në rënie krahasuar me vitin e kaluar. A është provuar ndonjëherë në lidhje me çështjen e transportit, apo ka ndodhur ndonjë ndryshim në shkollën profesionale? Me të vërtetë, thuhet se shkolla profesionale ka njëqind nxënës më pak se vitin e kaluar.

z. Zahir Doda: Në shkollën e mesme është një rënie më e vogël.

z. Agim Mani: Parashikohet që njëqind nxënës do t'i vijojnë mësimet në Ferizaj.

z. Zahir Doda: Ka mundësi, por nuk e kam atë të dhënë. Duke e krahasuar me ata që kanë përfunduar klasën e nëntë, ka më shumë se njëqind nxënës që nuk janë regjistruar. Kjo është një sfidë e madhe për çdo drejtor të Arsimit.

Këtë vit, numri i nxënësve nga parashkollorja deri në klasën e dymbëdhjetë është 255 më i vogël krahasuar me vitin e kaluar, që do të thotë se ka rreth 10 paralele më pak. Numri i mësuesve mbetet i njëjtë, megjithatë, po dalin në pension më pak mësues. Ka kufizime për punësim, dhe deri tani nuk kam përjashtuar asnjë nga sistemi.

Kemi arritur të kemi mirëkuptim me administratën komunale, e cila ka liruar disa hapësira. Nga ana tjetër, janë të nevojshme asistencë për nevoja të veçanta, që do të ndihmojë në rritjen e numrit të psikologëve, të cilët janë brenda normave. Kam psikolog në të gjitha shkollat.

Megjithatë, ky vit pritet të jetë edhe më i vështirë, pasi numri i nxënësve ka rënë ndjeshëm me 255 fëmijë më pak.

znj. Kadrije Lika –Troni: Drejtor, sa është numri i asistenteve për nevoja të veçanta në nivel komunal dhe a është ai i përmbushur?

z. Zahir Doda: Numri i asistenteve për nevoja të veçanta është njëmbëdhjetë. Kam gjithashtu dy vende të lira, por deri tani nuk është regjistruar asnjë në komunën tonë.

z. Rustem Zenuni: Drejtor, a është tentuar ndonjëherë në Asosacionin e Komunave të diskutohet për këtë çështje, përveç migrimin që nxënësit po bëjnë në vende të tjera? Pjesa më e madhe shkon në Ferizaj, ndërsa fshatrat si Begarac dhe Gllloboçica po shkojnë në Tetovë. A është diskutuar ndonjëherë që të vendosen kufizime, për shembull, që nxënësit që fillojnë klasën e parë brenda territorit të komunës së Kaçanikut të mos dalin jashtë komunës deri sa të përfundojnë shkollën e mesme?

znj. Ardita Rrahmani: As nuk duhet të diskutohet kjo, Rustem, sepse shumë qytetarë të Kaçanikut jetojnë në Prishtinë dhe janë të regjistruar në Kaçanik.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë tema dhe çështje që janë rregulluar me kushtetutë. Kushtetuta është baza që trajton elementet themelore të drejtave të njeriut dhe përcakton se çfarë ka të drejtë të bëjë dikush. Asosacioni është një organ rekomandues që pranon kërkesat tona dhe i transferon dikund, por nuk ka asnjë fuqi vendimmarrëse.

Duke folur për fëmijët nga Kaçaniku që shkojnë në shkollë në Ferizaj, Ferizaji nuk i pranon nëse ata nuk e dëshmojnë me një kontratë të notuar se janë duke banuar në Ferizaj. Kjo është një kusht që të gjithë e zbatojnë, duke e bërë kontratën me ndonjë person. Megjithatë, ata kërkojnë edhe një kontratë shtesë.

Për drejtime që nuk janë të profilit të atij fëmije në Kaçanik, për shembull, nëse dikush dëshiron të ndjekë shkollën e mesme në mjekësi, nuk mund të detyrohet të ndjekë drejtimin e hotelierisë. Ai dëshiron të ndjekë dizajn të modës ose interior, dhe nuk duhet t'i imponohet asgjë; përkundrazi, duhet t'i subvencionojmë ata fëmijë ose të krijojmë kushte për të hapur këto drejtime këtu.

znj. Ardita Rrahmani: Por edhe kur subvencionon një student për të ndjekur hotelierinë, duhet t'i kushtëzohet që të vijë të shërbejë në Kaçanik.

Po ndërlihem me Rustemin, kur tha se duhet të kushtëzojmë një fëmijë që të mos shkollohet në një vend tjetër, por vetëm në komunën tonë. Mandej, ai fëmijë duhet të mbështetet nga prindërit e tij, duke qëndruar në Gllloboçicë, e cila nuk ofron ndonjë perspektivë për rritje.

Duhet të flasim për mundësitë e punës për nënën dhe babanë e atij fëmije, të cilët duhet të gjejnë mundësi punësimi diku. Gllloboçica nuk ofron shumë mundësi, dhe na nevojitet një mënyrë për të stimuluar zhvillimin ekonomik.

Kemi nevojë për plane dhe strategji që do t'i ndihmojnë ata prindër dhe do të krijojnë më shumë mundësi për fëmijët tanë.

z. Zahir Doda: I vetmi drejtim që mund të ndalë pak më shumë nxënës në komunën tonë është mjekësia. Problemi i vetëm që kanë komunat e vogla është se nuk janë në gjendje të mbajnë

mjekët. Kjo e detyron mjekun të marrë në qafë fëmijët, sepse ligji i pagave nuk i mundëson atij të japë orët që kërkon për të mbajtur nxënësit. Prandaj, shumë orë humben, dhe për këtë arsye nuk jam ithtar i hapjes së drejtimeve të mjekësisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni të pajtimit që Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku, t'i adresohet Kuvendit të Komunës. Për me ia kaluar Kuvendit të Komunës Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku, votuan njëzëri të gjithë anëtarët e KPF. Në saje të kësaj del konstatimi së; KPF vendosi që, **Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku, t'ia përcjellë në procedurë të KK.**

9. Propozim Vendim Për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore deri në 5% sipas Buxhetit të vitit 2024

z. Agim Mani: Drejtor, a ka përfunduar ky projekt?

Kryetari i Komunës: Po, ka përfunduar. Veç ka mbetur obligimi për të mos e lënë vitin e ardhshëm, mjetet janë.

z. Zahir Doda: Projekti ka përfunduar, por ka mbetë pa u kry obligimi për hapjen e re të hyrjes shkollës.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendim Për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore deri në 5% sipas Buxhetit të vitit 2024

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin prezentë - 06.

Mbledhja e 9 e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 30.09.2024, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Mavije Murseli

